

ILIRIAN MARTIRI

ÇËSHTJE TË SINTAKSËS SHQIPE TË TRAJTUARA NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT

Në këtë kumtesë do të paraqiten aspekte të ndryshme shkencore të sintaksës së shqipes, sipas këndvështrimit të Camajt në veprën e tij “Albanian Grammar” botuar në vitin 1984. Synimi kryesor është një paraqitje sistematike e vlerave të këtij personaliteti të kulturës sonë në fushën e sintaksës shqipe.

Në njëzet e katër faqe të veprës së tij, nga faqja 233 deri në faqen 257, nëpërmjet 35 paragrafëve, autori paraqet një sintezë të njohurive bazë të sintaksës së shqipes për një publik të huaj, sipas mënyrës klasike të parashtrimit në vepra të tilla. Në këto faqe studiuesi ndalet në çështje të teorisë dhe të metodës sintaksore të shqipes, në trajtimin e konceptit bazë të fjalisë, në gjymtyrët përbërëse të fjalisë, në fjalitë e varura dhe në çështjet që lidhen me ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë.

Lidhur me çështjet e teorisë dhe të metodës, autori ndalet veçanërisht në vendin e sintaksës mes disiplinave të tjera gjuhësore, duke iu përmbajtur parimit se morfologjia (morfologjia) dhe sintaksa nuk ndahen shumë nga njëra-tjetra, pa lënë mënjanë arsyet e paraqitjes së vlerave të kësaj discipline nëpërmjet një parashtrimi të tillë të shkurtër e sintetik. Ai jep në mënyrë të organizuar një numër rregullash dhe shembujsh, të lidhur me pozicionet dhe marrëdhëniet mes elementeve bazë të fjalive, por dhe të vetë fjalive në raportet mes njëra-tjetrës.

Në këtë perspektivë, Camaj nuk ngurron të vërë në dukje se në gjendjen aktuale të zhvillimit të gjuhës letrare në sintaksën e shqipes bëhen evidente shumë e më shumë risi. Sipas tij, ka ardhur duke u rritur numri i dysorëve të njësive ligjërimore, si shprehje e shmangies nga normat e strukturës sintaksore të mëparshme të shqipes, por që gjithsesi, shumica e folësve nuk i percepton si të gabuara ose të papranueshme. Struktura të tilla hibride vihen re sidomos në gjuhën mediatike, në parashtrimet prozaikë dhe në mjaft përkthime të të gjitha llojeve.

Duke iu kthyer aspektit metodik të punës, Camaj thekson se strukturat sintaksore të varianteve gjuhësore paraqiten ashtu siç shfaqen në dallimet dhe ngjashmëritë e tyre, më shpesh si rezultat i dallimeve morfologjike.

Kështu, mjaft shembuj ilustrues janë marrë nga folklori letrar dhe nga frazeologjia folklorike (nga kanuni ose fjalë të urta). Bie në sy shtrirja e shembujve ilustrues të zgjedhur nga të dy kryedialektet e shqipes, gegë e toskë, por dhe nga arbëreshët e Italisë. Shembuj të tjerë janë zgjedhur nga letërsia e kultivuar, nga autorë në zë, si Fishta, Noli, Migjeni, Poradeci, Nikaj, N. Frashëri etj. Pra, në këtë kuadër, në kushtet e shtrirjes së kufizuar të një paraqitjeje sintetike, vihet re përpjekja për të mbuluar sa më shumë sfera të jetës dhe të përdorimit gjuhësor të shqipes, jo vetëm nga pikëpamja gjeografike, por edhe nga ajo kohore, në mënyrë që para publikut të huaj të jepen “pak e saktë” elemente tipike përfaqësuese të jetës së gjuhës shqipe, si një thirrje për realizimin e një gramatike të tipit “thesaurus” për shqipen, ku të kenë të drejtë të përfaqësohen sa më shumë të jetë e mundur nga trajtat dhe funksionet gjuhësore që dikton dinamika e përdorimit të kësaj gjuhe, pavarësisht nga norma standarde dhe, njëkohësisht, krahas saj.

Në sfondin e një panorame të tillë sintezë, Camaj përqendrohet për arsye metodike te koncepti bazë i fjalisë. Këtë e bën duke pasur parasysh përkufizimet që i janë bërë këtij nocioni dhe duke u përqendruar tek më i përshtatshmi përkufizim i fjalisë, sipas tij, si njësia ligjërimore më e vogël relativisht e pavarur, nëpërmjet së cilës shprehen mendimet. Që një përkufizim i tillë të jetë i vendosur në bazat më të qëndrueshme, autorit i duket e nevojshme që konceptet e formës dhe të funksionit të mos ndahen nga njëri-tjetri. Megjithatë, Camaj thekson se është pikërisht funksioni i fjalisë ku përqendrohet vëmendja kryesore, pasi ai ngërthen në vetvete dinamikën dhe përcaktimin e mendimit në struktura. Gjithashtu, në mënyrë që studentit të huaj që mëson sintaksën e shqipes t’i bëhet më komod qëndrimi në këtë fushë, Camaj vë në dukje se modeli i fjalisë së shqipes nuk ka dallim nga ai i fjalisë tipike pohore në gjuhën angleze, duke pasur të përbashkët skemën e përgjithshme strukturore: *kryefjalë – kallëzues – plotësor*.

Por gjuha përdoret dhe mësohet në dinamikën e saj dhe në atë të jetës në tërësi. Folësit e saj gjenden normalisht në situata nga më të ndryshmet, pa harruar edhe qëllimet e ndryshme që mund të kenë. Këtë ka parasysh edhe Martin Camaj kur paraqet dukuritë sintaksore të interpretuara natyrshëm sipas kësaj dinamike. Në këtë kuadër, preokupimi i tij mbeten shprehja e rrethanave ligjërimore, e përjashtimit të gjymtyrëve ose e ndërvendosjes së tyre, si dukuri të cilat bëhen shkak për ndryshime në cilësinë e ligjërimit. Gjithsesi, praktika ligjërimore me përdorimin e fjalive pohore, pyetëse, modale, urdhërore, këshillimore, dëshirore e habitore, me intonacionet dhe mënyrat shënuese grafike përkatëse, vijon të mbetet

thelbësore në kultivimin e shprehive gjuhësore për arritjen e qëllimit ligjërimit.

Më tej, në trajtimin e tij të sintaksës së shqipes, Camaj përqendrohet në të dhënat për gjymtyrët e fjalisë, qofshin këto kryesore, si kryefjala e kallëzuesi, qofshin gjymtyrë si kundrina apo plotës të tjerë. Lidhur me kryefjalën, përveç funksionit të saj të njohur në teorinë sintaksore, autori dallon kryefjalën gramatikore, kryefjalën psikologjike, kryefjalën logjike. Ndërsa për sa i përket kallëzuesit, veç përkufizimit të tij me funksion si dhënës i informacionit rreth kryefjalës, Camaj jep të dhëna për praninë e tij në fjali si i thjeshtë ose i përbërë, i shprehur me folje këpujore, i përsëritur, si kallëzues foljor ose emëror. Një zë më vete në trajtim e zënë kallëzuesit e shprehur me forma të shtjelluara të foljes dhe gjithashtu me forma të pashtjelluara, madje dhe në trajtime paralele, si mes formave vetore të foljeve dhe atyre të shprehura nëpërmjet infinitivit të tipit *me punue*. Ky i fundit me formën e tij sintetike zë në këtë parashtrim sintaksor një vend të gjerë, për shkak të funksioneve të shumta sintaksore që kryen në ligjërimit. Në këtë vepër nuk mungojnë të dhënat lidhur me kushtet në të cilat realizohet përshtatja mes kryefjalës dhe kallëzuesit në sintaksën e shqipes, në gjini, rasë, vetë dhe numër.

Nga ana tjetër, në trajtimin e çështjes së kundrinës, Camaj përqendrohet në të dhënat semantike lidhur me valencën, sipas të cilave folja kallëzues përcakton tipat e kundrinave të fjalive, si kundrina të drejta (shprehur me emra në rasën kallëzore) dhe të zhdrejta (shprehur me emër në rasën dhanore). Ky autor vë në dukje gjithashtu se në ngjashmëri me gjuhë të tjera të Ballkanit, edhe shqipja ka kundrina të dyfishta, njëra prej të cilave paraqitet si trajtë e shkurtër e përemrit vetor. Në këtë punim nuk lihen mënjane edhe një numër çështjesh që lidhen me gjymtyrët plotësuese të fjalisë.

Në veprën e Martin Camajt, në pjesën që i takon sintaksës së shqipes, një vend të gjerë gjejnë edhe frazat me bashkërenditje dhe nënrenditje, sipas skemës klasike. Fillimisht ai e vë theksin te konceptet përkatëse dhe më pas vijon me trajtimin metodik dhe hierarkik të vlerave gjuhësore.

Lidhur me fjalitë bashkërenditëse, Camaj e përqendron vëmendjen në ndarjen e tyre në asindetike (pa lidhëza) dhe sindetike (me lidhëza dhe me mjete të tjera sintaksore). Madje, ai është i mendimit se një faktor vendimtar në grupimin e fjalive me bashkërenditje është semantika e lidhëzave nëpërmjet të cilave ato lidhen. Për më tepër, fjalitë këtu qartësohen semantikisht në bazë të kuptimit të lidhëzave, mes të cilave ka edhe lidhëza dyfishe. Vetë lidhëzat dallohen sipas tipit këpujor, veçues, kundërshtues, apo rezultativ.

Edhe për sa u përket fjalive me nënrenditje, vazhdohet në të njëjtën perspektivë. Nga dija thelbësore të klasifikimi i të dhënave. Sipas Camajt, nënrenditja e fjalive përbën një tipar të vjetër të shqipes. Për më tepër, ndikimi i greqishtes së vjetër dhe i latinishtes romane nuk duhet nënvleftësuar. Kjo dukuri vihet re në shqipen e shkruar që nga koha e Buzukut, duke depërtuar nëpërmjet përkthimit të liturgjisë. Më pas vijon klasifikimi i fjalive me nënrenditje në kryefjalore, kundrinore, përcaktore dhe rrethanore (ndajfoljore). Këto të fundit, edhe në këtë vepër klasifikohen në fjali me nënrenditje kohore, shkakore, kushtore, mënyrore, lejore, qëllimore, krahasore. Edhe këtu spikatin nënkategorizime metodike dhe funksionale mjaft interesante.

Një zë më vete në këtë pjesë të veprës së Martin Camajt e zë edhe trajtimi i çështjeve të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë, që ngërthen në vetvete ndryshime të konsiderueshme morfologjike dhe sintaksore. Por pavarësisht nga këto ndryshime të formës, thelbi i përmbajtjes mbetet i njëjti. Gjithashtu, pjesa më e madhe e fjalorit të përdorur në ligjëratën e drejtë mbetet në përdorim edhe pas kthimit në ligjëratë të zhdrejtë.

Në përfundim, mund të thuhet se Martin Camaj parashtron një sintezë të sintaksës së shqipes. Kjo për arsye metodike të mësimi profesional dhe shkencor të shqipes nga të huajt, por edhe për të paraqitur disa tregues të gjendjes së saj veçanërisht gjatë shekullit të fundit, por edhe më parë, si pika referimi për studime të mëtejshme më të thelluara në secilën prej ndarjeve dhe nënndarjeve të këtij punimi të integruar në një vepër të mirëfilltë. Edhe pse një parashtrim tepër konciz dhe sintetik, arrihet të paraqitet një pamje më e plotë e mundshme e gjendjes së shqipes, si në hapësirat gjeografike dhe shoqërore ku përdoret, ashtu edhe në kohë, si një pikë referimi për gramatika gjithëpërfshirëse të tipit “thesaurus”.